

Zj. Aulona Jani ka kryer studimet e larta në periudhën 2000-2004, për Financë-Kontabilitet, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Ndërsa gjatë periudhës 2011-2013, ka përfunduar programet e studimit “Master në Administrim Biznesi” po në këtë Fakultet.

Ajo gëzon një eksperiencë administrative mbi 7 vjecare në fushën e auditimit të jashtëm publik, si dhe një eksperiencë të mëparshme 10 vjeçare në sistemin bankar, ku ka qenë e angazhuar në pozicione të ndryshme në fushën e kredidhënies së korporatave.

Prej vitit 2014, ajo ka ushtruar pozicionin e audituesit, e më pas kryeaudituesit në departamente auditimi.

Aktualisht mban pozicionin e Drejtorit pranë Departamentit të Metodologjisë Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.

Në vitin 2015, Zj. Jani ka ndjekur për një periudhë 5 mujore, programin e “Internship”-it në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), në Luksemburg, ku ka qenë pjesë e Njesisë së Besueshmërisë së Pasqyrave Financiare (CEAD), përgjegjësia e të cilës konsiston në përgatitjen dhe hartimin Deklaratën e Sigurisë mbi besueshmërinë e Pasqyrave Financiare të Komisionit Evropian.

Gjithashtu, në vitin 2017, për një periudhë 4 mujore, zj. Jani ka qenë pjesë programit të trajnimit “International Auditor Fellowship Program”, në GAO – “Zyra e Llogaridhënies së Qeverisë së SHBA-ve”, në Washington DC, ku ka ndjekur 640 orë trajnimi të përbërë nga kurse, seminare dhe e-learning, si dhe ka përgatitur punimin strategjik “Nje qasje drejt permiresimit të kontrolleve te brendshme në sektorin publik në Shqiperi mbështetur në eksperiencën e GAO-s”.

Gjatë karrierës së saj profesionale ka marrë pjesë në trajnime, kongrese, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me çështje të auditimit të jashtëm publik dhe institucioneve supreme të auditimit.

Zj. Jani është njohëse shumë i mirë e gjuhës angleze dhe italiane.